



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA  
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË SHKALLËS SË PARË  
VLORË

# ANALIZA VJETORE 2019



[www.pp.gov.al/prokuroriavlore](http://www.pp.gov.al/prokuroriavlore)

## PËRMBATJA E LËNDËS

H Y R J E .....	1
I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019 .....	1
I/1. Respektimi i të drejtave të njeriut.....	1
I/2. Të miturit dhe grupet vunerabël, si të pandehur dhe viktima.....	1
I/3. Bashkëpunimi ndërinstitucional. ....	2
I/4. Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	3
I/5. Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive.....	3
I/7. Në lidhje me zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019.....	4
I/8. Çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që zgjidhen,.....	7
Emërohen, ose Ushtrojnë Funksione Publike.....	7
I/9. Temat dhe numri i trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.....	7
apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit.....	7
II/1. Volumi i punës në hetim. ....	9
II/2 Çështjet e përfaqësuara në gjykatë.....	10
II/3. Treguesit kryesor të punës së prokurorisë.....	12
II/3.1. Të dhënat për vendimet e mosfillimit të procedimit penal.....	12
II/3.2 Të dhënat në lidhje me procedimet penale të pushuara.....	13
II/3.3 Çështjet penale të pezulluara gjatë vitit 2019. ....	13
II/3.4 Çështjet penale të transferuara gjatë vitit 2019.....	14
II/3.5 Çështjet penale të dërguara për gjykim. ....	15
II/4. Të dhënat në lidhje me njoftimet për veprat penale. ....	15
II/5 Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror.....	17
II/5.1 Treguesit e masave të sigurimit personal.....	17
II/5.2 Treguesit e masave të sigurimit pasuror. ....	18
II/6 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.....	19
II/7. Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë.....	20
II/8 Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre. ....	20
II/9 Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal.....	21
II. Treguesit statistikorë 2 vjeçarë të veprave penale sipas strukturës së kodit penal. ....	23
IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të prokurorisë.....	23
IV/1 Treguesit e efektivitetit në gjykimin dhe dënimeve të të pandehurve. ....	23
IV/2. Të dhënat për gjykimet e posaçme. ....	24
IV/3. Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve.....	24
IV/4 Të dhënat sociale dhe demografike për të pandehurit. ....	25

IV/5. Të dhënat për të pandehurit e mitur.....	25
IV/6. Të dhënat për pasojat e veprave penale.....	26
V. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetit e huaja.....	26
V/2 Letërporosi nga jashtë.....	27
V/3 Njohja e vendimeve penale te huaja.....	27
V/4 Transferime të procedimeve penale.....	27
V/5 Transferimet e personave të dënuar.....	27
V/6 Shpalljet në kërkim ndërkombëtar.....	27
VI. Ngarkesa e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore.....	28
VII. Informacion mbi administrimin e prokurorisë.....	31
VII/1 Marrëdhëniet me zyrën e financës.....	31
VII/2. Marrëdhëniet me median dhe publikun.....	32
VII/3. Rregullsia e mbajtjes së regjistrave dhe raporteve.....	32
VII/4. Mbi zbatimin e sistemit CAMS.....	32
VII/5. Kapacitetet infrastrukturore dhe siguria.....	33
VII/6. Respektimi i disiplinës në punë dhe etikës.....	33
VIII. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019.....	34

## H Y R J E

Ky raport pasqyron në mënyrë të përmbledhur rezultatet e veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, gjatë vitit 2019. Ai është përqëndruar në analizën e treguesve kryesore sasiorë të punës, treguesit cilësorë, referuar edhe qëndrimeve të gjykatës, treguesit për secilin prokuror dhe OPGJ, problematikën gjatë ushtrimit të funksioneve të prokurorit në hetimet paraprake dhe në gjykim, me synimin për të evidentuar mangësitë dhe arritjet dhe me qëllim përmirësimin e treguesve të punës për vitin që vijon.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, sipas organikës së miratuar nga Prokuroria e Përgjithshme, ka patur për vitin 2019 një organikë prej 45 (dyzet e pesë) punonjësish nga të cilët: 1 drejtues, 1 zv/drejtues, 18 prokurorë, 9 oficerë të policisë gjyqësore, 1 kancelar, 1 k/sekretare, 1 Kryetare Degës se Buxhetit, 1 shofer, 1 ftues, 1 Specialist I.T, 7 sekretare pranë prokuroreve, 1 punonjës shërbimi, 1 punonjës pastrimi dhe 1 koordinator

Por gjatë vitit 2019 ka patur lëvizje (caktime të përkohshme, leje, etj.) të prokurorëve dhe OPGJ, ku një OPGJ i emëruar gjatë vitit 2019 nga Prokurori i Përgjithshëm nuk u paraqit në detyrë, duke lënë vendin vakant.

Sipas organizimit të brendshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë kanë funksionuar për gjatë vitit 2019 rregullisht 4 (katër) seksione:

1. Seksioni Kundër Krimin Ekonomik, dhe krimin kibernetik me 3 prokurorë (Një drejtues seksioni dhe 2 *prokurorë*).
2. Seksioni i veprave të tjera Penale me 11 Prokurorë (Një drejtues seksioni dhe 10 prokurorë).
3. Seksioni i të Miturve dhe Ekzekutimit të Vendimeve Penale, me 3 prokurorë (Një drejtues seksioni dhe 2 prokurorë).
4. Seksioni i Posaçëm, i krijuar sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë të Brendshme, në të cilin janë atashuar 3 prokurorë (Një drejtues seksioni dhe 2 prokurorë).

## I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019

Prokuroria e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Kushtetutën, me Kodin Penal, me Kodin e Procedurës Penale, si dhe gjithë kuadrin ligjor që rregullon mënyrën e organizimit të këtij institucioni, mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale nga prokurori, ngritjen akuzës, kryerjen e hetimeve, në respektim të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut si dhe në bashkëpunim me faktorë të tjerë shoqëror ndërinstitucional.

### *I/1. Respektimi i të drejtave të njeriut.*

Mbrojta e të drejtave të njeriut është konsideruar si një prioritet i punës së prokurorisë për vitin 2019 dhe veçanërisht, në lidhje me respektimin e të drejtave të të miturit në procesin penal dhe grupet vunerabël dhe respektimin e të drejtave të viktimës së veprës penale. Nga ana e prokurorëve i është kushtuar kujdes rasteve të ndalimit apo arrestimit, duke vlerësuar kriteret përkatëse ligjore me qëllim që të mos privohet liria në mënyrë arbitrare. Për gjatë vitit 2019, rezulton se nga prokurorët është urdhëruar lirimi i menjëhershëm për 3 (tre) raste, me arsyetimin se nuk janë respektuar kërkesat dhe kriteret ligjore për arrestimin e apo ndalimin e personave. Ndërsa nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se vetëm në 7 (shtatë) raste është konsideruar arrestimi apo ndalimi i paligjshëm.

### *I/2. Të miturit dhe grupet vunerabël, si të pandehur dhe viktima.*

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, funksionin Seksioni për të Miturit, Ekzekutimet e Vendimeve Penale dhe Marrëdhëniet Juridiksionale, i cili përbëhet nga 3 (tre) prokuror dhe 1 (një) oficer i policisë gjyqësore. Në lidhje me të miturit dhe grupet vunerabël, si të pandehur dhe viktima, rezulton se në çdo rast i është siguruar të miturit në procesin penal mbrojtja e tij me avokat dhe padyshim prania e një psikologu për mbrojtjen e të drejtave të tij. Është treguar kujdes në njoftimin e menjëhershëm të personave kujdestar të të miturit, qoftë prindi apo tjetër, në fshehtësinë e informacionit dhe ndalimin e publikimit për të miturit e abuzuar, apo palë në proces, veçanërisht për çështje që kanë ndjeshmëri në opinionin publik.

Në rastet e të miturve në cilësinë e të pandehurve janë aplikuar masa sigurimi të përshtatshme duke treguar kujdes, në mënyrë që të mos ndërpritet procesi edukativ dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. Ndërsa në lidhje me masat e dënimit, janë shtuar rastet e dënimeve alternative, rastet e përjashtimit të të miturit në konflikt me ligjin nga përgjegjësia penale, si dhe është vlerësuar me kujdes çdo material që në fazën e referimit të tij. Rezulton se përgjithësisht është ndjekur një politikë penale më e butë ndaj të miturve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara, ku vetëm në raste të veçanta është kërkuar masa e sigurimit "Arrest në burg" ndaj të miturve që janë proceduar penalisht për vepra të rënda si vrasje dhe vjedhje me dhunë, dhe përjashtimisht në disa raste për vjedhje të kryer në bashkëpunim e më shumë se në herë, nga subjekte përsëritës dhe problematikë për komunitetin. Gjithashtu, rezulton se në 31 (tridhjetë e një) procedime penale janë marrë masa alternative duke shmangur të miturin në konflikt me ligjin nga përgjegjësia penale.

Në lidhje me problematikat e këtij seksioni, rezulton se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 është konstatuar një numër i madh i çështjeve, pasi nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Fier dhe Lushnjë është shpallur moskompetenca dhe janë dërguar aktet procedurale në të gjitha rastet kur i pandehuri apo viktimja është i mitur. Për këto arsye rezulton se është rritur numri i çështjeve, duke krijuar vështirësi në lidhje me garantimin e të drejtave të subjekteve, për faktin se viktimat vijnë nga rrethe të largëta dhe të shoqëruar me prindërit, ku në shumë raste ndodhen edhe para vështirësisë financiare për të paguar udhëtimin, dhe janë hasur problematika në njoftime .

Me krijimin e seksioneve të të miturve në këto rrethe gjyqësore në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2019, rezulton se kjo problematikë është zgjidhur. Gjithashtu, problematikë tjetër e konstatuar është mungesa e një zyrë përkatëse në ambientet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Vlorë për pyetjen e kësaj kategorie personash.

Në vitin 2019 është shtuar një punonjës koordinator i cili i vjen në ndihmë kësaj kategorie dhe më gjerë, në lidhje me ndihmesën e kërkuar dhe bashkërendimin e punës me institucionet e tjera të pushtetit lokal, apo organizatave të ndryshme të cilat japin kontribut dhe ndihmesë për viktimat dhe për kategoritë vunerabël në procesin penal.

### *I/3. Bashkëpunimi ndërinstytucional.*

Gjatë vitit 2019 është synuar rritja e bashkëpunimit sidomos me strukturat e policisë së shtetit, si një nga bashkëpunuesit kryesor për përmirësimin e punës dhe arritjen e suksesit në hetimin e çështjeve penale si dhe evidentimin e situatave problematike. Ky bashkëpunim ndërinstytucional ka qënë produktiv dhe mbështetës për kërkesat e policisë, por edhe për delegimet e veprimeve hetimore dhe kryerjen e detyrave nga ana e tyre. Ka qënë një bashkëpunim i fokusuar jo vetëm në nivel drejtimi por një bashkëpunim edhe në nivelin bazë. Ka pasur komunikim të vazhdueshëm përsa i përket ngjarjeve të rënda dhe me ndikim në opinion publik sikurse dhe nga ana e prokurorisë në çdo rast nuk ka munguar prezenca e prokurorit në vendngjarje. Synohet në këtë drejtim rritja e bashkëpunimit, përmirësimi i punës së oficerëve të policisë gjyqësore, rritja e komunikimit mes tyre dhe prokurorit në kryerjen e detyrave të përcaktuara në urdhërin e delegimit apo për kryerje veprimesh hetimore, moszvarritja e pajustificuar e hetimit me qëllim rritjen e cilësisë së hetimit për të qënë më të suksesshëm në parandalimin dhe goditjen, sidomos të veprave penale më të përhapura në këtë rreth.

Bashkëpunim specifik dhe me rëndësi të veçantë është ai që i përket institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, konkretisht me IEVP Vlorë dhe Shërbimin e Provës, ku marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ka qënë korrekt.

Referuar të dhënave statistikore, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka përkrahur kërkesat dhe qëndrimet e organit të akuzës, e dhënë kjo që tregon se kërkesat dhe qëndrimet e prokurorëve kanë qënë në përputhje me ligjin. Ky fakt konstatohet si në vendimet në lidhje me masat e sigurimit dhe masat e dënimit ashtu edhe në përkrahjen ligjore, procedurale për pjesën e hetimit me metoda speciale. Ajo që mbetet të rishikohet në këtë bashkëpunim janë kryesisht qëndrimet e ndryshme të mbajtura për disa raste në seancat gjyqësore paraprake, ku kualifikimi i veprës penale i bërë nga ana e prokurorëve është ndryshuar prej gjykatës.

Në vijim të këtij bashkëpunimi, ka qënë mjaft produktiv, i shpejtë dhe korrekt komunikimi zyrtar në lidhje me shkresat, kthimet e përgjigjeve, vënia në dispozicion e dokumentacionit të kërkuar.

Me Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ruhen marrëdhënie të mira dhe institucionale. Kjo prokurori na ka mbështetur në të gjitha kërkesat tona të ligjshme dhe ka orientuar qëndrimin tonë për çështje konkrete, si dhe komunikimi me prokurorët e apelit ka qënë i shpeshtë dhe rezultativ.

Një bashkëpunim i veçantë dhe produktiv ka qënë për vitin 2019, bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme, në krijimin dhe vënien në dispozicion të ekspertëve të pavarur në fusha të caktuara, i cili ka dhënë zgjidhje problemeve me ekspertët dhe shpejtësinë e hetimit, në fushën e marrëdhënieve juridiksionale, etj.

Po ashtu, një vëmendje e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, DPPPP Tiranë, Shërbimin Informativ Shtetëror, Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, Degën e Doganës Vlorë, Drejtorinë Rajonale të Hetimit Tatimor Rajoni Jugor, Fier, me qëllim rritjen e rasteve të hetimit të veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe përmirësimit të materialeve të para hetimore.

#### *I/4. Bashkëpunimi ndërkombëtar.*

Në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, si hartimi i letërporosive, njohje vendimi të huaj, ekzekutim i letërporosive, ekstradime etj, ka pasur bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar duke ndikuar ndjeshëm në çështjet që lidhen me trafiqet e paligjshme, dhe konkretisht me autoritetet gjyqësore italiane, greke, etj. Rezulton se të gjitha kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtar janë përcjellë përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe nuk evidentohet ndonjë rast kur kërkesa është drejtuar drejtpërdrejtë pranë organit gjyqësor kompetent të shtetit që i drejtohet kjo kërkesë e posaçërisht Republikës së Italisë, me të cilën shteti shqiptar ka nënshkruar edhe marrëveshjen përkatëse. Konstatohet një korrektësi maksimale në raport me autoritet gjyqësore të huaja në përmbushje e detyrimeve ligjore, në një kohë kur pritet që edhe autoritete e huaja gjyqësore të na përgjigjen të njëjtën shkallë korrektësie.

#### *I/5. Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive.*

Në lidhje me hetimet proaktive, rezulton se ka një rritje të këtyre hetimeve, por rezulton se të dhënat e para të siguruara nga shërbimet e policisë gjyqësore janë në një cilësi të dobët, ku materialet referohet sipas nenit 293 të K.Pr.Penale, duke pasqyruar vetëm referimin, por të pashoqëruar me të dhëna apo indice konkrete. Për gjatë vitit 2019, janë kryer hetime proaktive në kuadër të 46 (dyzetë e gjashtë) procedime penale për vepra të ndryshme penale. Rezulton se 24 (njëzet e katër) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal; 9 (nëntë) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal; 5 (pesë) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal; 2 (dy) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal; 1 (një) procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 298 të Kodit Penal; 1 (një) procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni

121/a i Kodit Penal; 1 (një) procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal; 1 (një) procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal; 2 (dy) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal. Në disa prej hetimeve të këtyre procedimeve penale, rezulton se vëzhgimi dhe filmimi në ambiente publike i autorizuar nga prokurori në shumë raste nuk ka qenë i suksesshëm, për shkak të mungesës së strukturave përkatëse në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë dhe burimeve njerëzore. Në lidhje me veprat e mësipërme, rezulton se prokurorët përgjithësisht kanë kërkuar dënime të ashpra, si dhe kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, ndaj personave të proceduar për kryerjen e këtyre veprave penale.

#### *I/6. Zbatimi i Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.*

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë njohur oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe personeli i prokurorisë me të gjitha Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm. Pas njohjes me Udhëzimet përkatëse, Drejtuesi i Prokurorisë në zbatim të nenit 42 gërma “d” dhe 55 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ka thirrur mbledhjen e prokurorëve dhe janë diskutuar udhëzimet përkatëse ku ju është lënë detyrë Drejtuesve të Seksioneve që të ndjekin me përpikmëri zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme dhe në rast se konstatohen problematika në lidhje me zbatimin e tyre, të identifikohen ato me qëllim analizimin e situatës dhe mundësinë e nxjerrjes së udhëzimeve përkatëse. Përsa i përket Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 04, datë 26/10/2018 “Për Përgjimet”, çmobjmë se është e nevojshme ekzistenca e një zyre, e cila duhet që të shërbejë vetëm për depozitimin e materialeve të përgjimit dhe vënien në dispozicion të këtyre materialeve personave përkatës që ligji ua jep këtë të drejtë.

#### *I/7. Në lidhje me zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019.*

Në lidhje me angazhimet, arritjet dhe problematikat në zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019, rezulton se me aktet e mësipërme janë njohur të gjithë prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe është kërkuar prej tyre dhe drejtuesve të seksioneve që të ndjekin me përpikmëri zbatimin e rekomandimeve dhe kërkesat përkatëse të parashtruara në aktet e mësipërme.

Me qëllim rritjen e cilësisë së hetimeve për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, kultivimit të bimëve narkotike dhe kimit ekonomik e financiar, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për gjatë vitit 2019, kanë funksionuar dy seksione. Konkretisht seksioni kundër kimit ekonomik-financiar dhe kimit kibernetik dhe seksioni i posaçëm, ku ky i fundit ka ndjekur përgjithësisht hetimet për veprat penale të pastrimit të

produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, kultivimit të bimëve narkotike. Në dy seksionet e mësipërme janë angazhuar përkatësisht nga tre prokurorë, ku në përzgjedhjen e tyre i është kushtuar rëndësi eksperiencës së tyre në punë, si dhe kualifikimeve dhe trajnimeve përkatëse të ndjekura nga prokurorët.

Gjatë vitit 2019 janë regjistruar gjithsej 7 (shtatë) procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

Për gjatë vitit 2019 është regjistruar 1 (një) procedim penal kryesisht, si dhe 47 (dyzet e shtatë) procedime penale mbi bazën e vendimit të ndarjes së çështjes.

Rezulton se për gjatë vitit 2019, janë kryer hetime proaktive në kuadër të 46 (dyzet e gjashtë) procedime penale për vepra të ndryshme penale. Rezulton se 24 (njëzet e katër) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal; 9 (nëntë) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal; 5 (pesë) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal; 2 (dy) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal; 1 (një) procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 298 të Kodit Penal; 1 (një) procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal; 1 (një) procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal; 1 (një) procedim penal është regjistruar për veprën penale të parashikuar nga nenet 79 të Kodit Penal, si dhe 2 (dy) procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal.

Në lidhje me veprat e mësipërme, rezulton se prokurorët përgjithësisht kanë kërkuar dënime të ashpra, si dhe kanë kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, ndaj personave të proceduar për kryerjen e këtyre veprave penale. Gjatë vitit 2019 nuk është arrestuar apo kërkuar masë sigurimi “Arrest në burg”, për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Rezulton se për 8 (tetë) procedime të ndryshme të regjistruara për veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 78, 79, 283 dhe 284 të Kodit Penal janë kërkuar nga prokurorët 73 (shtatëdhjetë e tre) masa sigurimi “Arrest në burg”.

Gjatë vitit 2019 rezulton se janë referuar 26 (njëzet e gjashtë) materiale për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Rezulton se në lidhje me këto materiale referuese, për 6 (gjashtë) raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal, ndërsa për 17 (shtatëmbëdhjetë) raste është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ndërsa rastet e tjera janë mbartur në vitin 2020 në fazën e verifikimit të kallëzimit penal. Nga këto procedime penale, vetëm 1 (një) procedim penal është pushuar, ndërsa procedimet e tjera ndodhen në fazën e hetimeve paraprake. Gjatë vitit 2019 nuk është marrë vendim fajësie në lidhje me të akuzuarit sipas nenit 287 të Kodit Penal.

Rezulton se gjatë vitit 2019, nuk ka pasur të regjistruara hetime paralele për pastrim të parave në rastet e hetimeve për krime serioze që gjenerojnë të ardhura, si dhe hetime pasurore për produktet kriminale të krijuara brenda vendit dhe të ardhura nga jashtë vendit.

Për gjatë vitit 2019, janë regjistruar 56 (pesëdhjetë e gjashtë) procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Rezulton se 37 (tridhjetë e shtatë) procedime penale janë dërguar për gjykim, 13 (trembëdhjetë) procedime penale janë pushuar.

Rezulton se për gjatë vitit 2019 janë dënuar gjithsej 45 (dyzet e pesë) të pandehur të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

Për gjatë vitit 2019, janë regjistruar 80 (tetëdhjetë) procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal. Rezulton se 37 (tridhjetë e shtatë) procedime penale janë dërguar për gjykim, 13 (trembëdhjetë) procedime penale janë pushuar. Rezulton se për gjatë vitit 2019 janë dënuar gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) të pandehur të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal.

Bazuar në numrin e çështjeve të regjistruara për këtë vepër penale, çmojmë se është e nevojshme angazhimi/shtimi i numrit të oficerëve të policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, si dhe rritja e cilësisë së materialeve të para hetimore.

Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, rezulton se në hetimet paraprake konstatohet si pengese pamundësia për të lidhur pasurinë e identifikuar me veprimtarinë apo veprën penale të kryer nga personi posedues i pasurisë. Në shumë raste materialet hetimore referohen vetëm mbi bazën e identifikimit të pasurisë, por pa specifikuar veprën penale mëmë apo veprimtarinë kriminale nga të cilat mund të jenë realizuar këto të ardhura. Në mungesë të këtyre të dhënave është bërë e pamundur edhe paraqitja e kërkesës për caktimin e masës së sekuestros preventive në momentin e regjistrimit të procedimit penal.

Pengesë tjetër e konstatuar në hetimet paraprake ka të bëjë me faktin se personat posedues të pasurisë së identifikuar referohen për të dhëna kriminale të kryera në shtete të huaja. Kjo ka shkakuar vonesa në hetimin e këtyre veprave penale, për faktin se të dhënat janë administruar përmes letërporosisë dhe në shumë raste është konstatuar se personat e referuar kanë marrë vendime pafajësie të formës së prerë në shtetet e huaja. Ndërsa në raste të tjera është konstatuar se pavarësisht përfshirjes së personit në veprimtari kriminale, pasuria e identifikuar ka rezultuar se mbulohet me burime të ligjshme sipas ekspertimit kontabël.

Po ashtu, pengesë tjetër e konstatuar në hetimet paraprake ka të bëjë me pamundësinë për të evidentuar lidhjen ndërmjet pasurisë së identifikuar dhe veprës bazë apo veprimtarisë kriminale të kryer nga personi posedues i pasurisë. Kjo për shkak se pasuria është regjistruar apo identifikuar shumë vite më vonë se sa kryerja e veprës penale apo përfshirjes në veprimtari kriminale të personit posedues të pasurisë. Vështirësi në këtë drejtim ka ardhur edhe për shkak të informalitetit të ekonomisë shqiptare, si dhe për shkak se shumë persona apo familjarë të tyre deklarojnë se një pjesë të pasurisë e kanë përfutur si pasojë e emigrimit dhe kryerjes së punëve të ndryshme por të paregjistruar në shtetet e huaja.

Të gjitha problematikat e mësipërme kanë ndikuar në mënyrën e përfundimit të hetimeve, e për këto arsye numri i rasteve që dërgohen në gjykatë është i ulët. Ndërsa në lidhje me problematikat e konstatuara gjatë fazës së gjykimit rezulton se problematika kryesore ka të bëjë me interpretimin juridik të elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Nga gjykata kërkohet që të identifikohet vepra mëmë apo veprimtaria kriminale, të provohet se pasuria konkrete e identifikuar është krijuar si pasojë e kryerjes së veprës penale apo përfshirjes në veprimtari kriminale, si dhe të provohet kryerja e një nga veprimeve të anës objektive të kësaj vepre penale me pasurinë e përfutur nga kryerja e veprës penale apo veprimtarisë kriminale.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale dhe rritjen e numrit të hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, si dhe rritjen e numrit të asetëve të sekuestruara/konfiskuara, si dhe për zbatimin e

ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, çmojmë se është e nevojshme zhvillimi e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Gjithashtu, çmojmë se në zbatim të nenit 67 të ligjit nr. 97/2016, është e nevojshme që të ngrihet dhe të funksionojë një sektor ekspertize me ekspert në fushën ekonomiko-financiare në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Rezulton se për gjatë vitit 2019, nga prokurorët janë përdorur institutet procedurale si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, si dhe gjykimi i drejtëpërdrejtë. Rezulton se për 54 (pesëdhjetë e katër) procedime penale, nga prokurorët janë nxjerrë urdhra penal, ndërsa për 49 (dyzet e nëntë) procedime penale rezulton se është hartuar marrëveshja e fajësisë, si dhe për 40 (dyzetë) procedime penale është operuar me ritin e gjyqimit të drejtëpërdrejtë.

Në lidhje me zbatimin e kuadrit të ri ligjor lidhur me drejtësinë për të miturit, për gjatë vitit 2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka funksionuar Seksioni për të Miturit, Ekzekutimet e Vendimeve Penale dhe Marrëdhëniet Juridiksionale, i cili përbëhet nga 3 (tre) prokuror dhe 1 (një) oficer i policisë gjyqësore. Në rastet e të miturve në cilësinë e të pandehurve janë aplikuar masa sigurimi të përshtatshme duke treguar kujdes, në mënyrë që të mos ndërpritet procesi edukativ dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri, si dhe në lidhje me masat e dënimit, janë shtuar rastet e dënimeve alternative apo janë vlerësuar me kujdes çdo material që në fazën e referimit të tij. Rezulton se përgjithësisht është ndjekur një politikë penale më e butë ndaj të miturve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara, ku vetëm në raste të veçanta është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg” ndaj të miturve që janë proceduar penalisht për vepra të rënda si vrasje dhe vjedhje me dhunë, dhe përjashtimisht në disa raste për vjedhje të kryer në bashkëpunim e më shumë se një herë, nga subjekte përsëritës dhe problematikë për komunitetin. Gjithashtu, rezulton se në 31 (tridhjetë e një) procedime penale janë marrë masa alternative duke shmangur të miturin në konflikt me ligjin nga përgjegjësia penale.

Gjatë vitit 2019 rezulton se janë referuar materiale hetimore dhe janë paraqitur kallëzime penale nga shtetas apo institucione në total 3236 (tremijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) materiale.

*I/8. Çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen, ose Ushtrojnë Funksione Publike.*

Rezulton se për gjatë vitit 2019 janë dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme 2 (dy) materiale në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015. Në lidhje me këto 2 (dy) materiale rezulton se është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal, ku në një rast është paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes dhe në rastin tjetër është paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

*I/9. Temat dhe numri i trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit.*

Në lidhje me trajnimet e kryera nga prokurorët rezulton se trajnimet janë kryer nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga komunikimi me prokurorët rezulton se të dhënat për këto

trajnime ndodhen në dosjet personale të tyre, të dhëna këto që dërgohen nga Shkolla e Magjistraturës. Rezulton se prokurorët kanë përmbushur detyrimin ligjor për të ndjekur trajnimet përkatëse në temat që ata kanë përzgjedhur.

Me qëllim zbatimin me korrektesë të dispozitave procedurale penale, pas ndryshimeve të bëra përmes ligjit 35/2017, janë organizuar takime me të gjithë oficerët e policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë. Këto takime janë zhvilluar me pjesëmarrjen e disa prokurorëve, të cilat kanë reklamuar ndryshimet përkatëse të dispozitave procedurale penale, problematikat e hasura gjatë punës së oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe kanë orientuar zbatimin e detyrimeve procedurale ndaj viktimave të veprës penale, të pandehurve të mitur, viktimave të mitur dhe ndaj dëshmitarëve të mitur.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale dhe rritjen e numrit të hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, si dhe rritjen e numrit të aseteve të sekuestruara/konfiskuara, çmoj se është e nevojshme zhvillimi i disa trajnimeve më prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, për faktin se ky ligj zbatohet edhe nga prokurorët e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Gjatë vitit 2019 i është kushtuar prioritet luftës kundër krimit ekonomik dhe krimit në fushën e lënëve narkotike dhe kultivimit të bimëve narkotike, duke vlerësuar çdo material të referuar si nga institucionet bashkëpunuese, apo çdo qytetar, duke rritur hetimin për veprat penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në këtë drejtim vlerësohet puna e seksionit kundër krimit ekonomik dhe krimit kibernetik, si dhe seksionit të posaçëm, ku përmes hetimeve të prokurorëve dhe oficerëve të këtyre seksioneve është bërë e mundur sekuestrimi i pasurive në vlera të mëdha.

Ndjeshmëri të lartë për vitin 2019 ka paraqitur posaçërisht krimi në fushën e narkotikëve, ku rezulton se ka pasur referime për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, “ Prodhim dhe mbajtja e narkotikëve” , qoftë edhe në sasi të vogla. Me qëllim rritjen e cilësisë së hetimeve dhe efektivitetit të hetimit në lidhje me këto vepra penale është ngritur seksioni i posaçëm, i përbërë nga tre prokurorë. Gjatë këtij viti ka pasur gjithashtu referime të materialeve që lidhen me kapjen e mjeteve motorrike, konkretisht gomoneve, të pamatrikulluara me dyshime për trafik të lëndëve narkotike.

Duke u konsideruar si një nga prioritet kryesore lufta kundër narkotikëve, janë organizuar në nivele vendore takime me përfaqësues të njësive territoriale (lidhur me rastet e kultivimit të bimëve narkotike), me përfaqësues të Prefekturës, Prokurorisë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, të cilat kanë rezultuar të suksesshme duke dhënë dhe rezultate konkrete. Vlen të theksohet se në hetimin e këtyre grup veprave penale, janë përdorur metodat proaktive të hetimit, ku përgjimet dhe autorizimet e vëzhgimeve janë konsideruar si mjeti më efikas në zbulimin dhe identifikimin e autorëve të veprës penale.

## II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË PËR VITIN 2019.


### II/1. Volumi i punës në hetim.

Gjatë vitit 2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë regjistruar gjithsej 3236 (tremijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) kallëzime dhe referime për vepra të ndryshme penale. Prej tyre janë regjistruar gjithsej 2178 (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë) procedime penale dhe është vendosur mosfillimi për 1119 (njëmijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) kallëzime penale. Janë mbartur nga viti 2018 gjithsej 887 (tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) procedime penale, si dhe 128 (njëqind e njëzet e tetë) materiale në verifikim. Nga këto të dhëna rezulton se për vitin 2019 janë trajtuar gjithsej 4251 (katërmijë e dyqind e pesëdhjetë e një) materiale.

Krahasuar me të dhënat e vitit 2018, rezulton se për gjatë 2019 janë regjistruar 439 (katërqind e tridhjetë e nëntë) materiale referuese/kallëzime më pak.

Totali i çështjeve të trajtuara		Të regjistruara	Të mbartura viti paraardhës	Seksioni i të Miturve
Viti 2019	4251	3065 <sup>1</sup> + 67 <sup>2</sup> (1119 <sup>3</sup> mf)	1151	142
Viti 2018	4392	3069+128 (1195 mf)	887	152

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm, paraqiten si më poshtë: **Graf 1**




<sup>1</sup> Procedime të rregjistruara për vitin 2019.

<sup>2</sup> Referime që nuk kanë marrë numër procedimi penal (materiale në verifikim) + (materiale të bashkuara.

<sup>3</sup> Çështje të mosfilluara për vitin 2019.

2019	1914 <sup>4</sup> + 1151 <sup>5</sup> + 1119 + 67 <sup>6</sup> = 4251	1914 + 1119 = 3033	1151
2018	2445 + 624 + 1195 + 128 = 4392	2179 + 1195 = 3374	887

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm, paraqiten si më poshtë: Graf 2



### III/2 Çështjet e përfaqësuara në gjykatë.

Gjatë vitit 2019 janë dërguar për gjykim 585 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë) procedime penale me 707 (shtatëqind e shtatë) të pandehur. Nga këto procedime penale rezulton se ka përfunduar gjykimi për 518 (pesëqind e tetëmbëdhjetë) procedime penale me 611 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë) të pandehur. Rezulton se për 30 (tridhjetë) procedime penale me 39 (tridhjetë e nëntë) të pandehur është dhënë vendim pafajësie. Në raport me procedimet e përfunduara për vitin 2019, rezulton se 30.6% e këtyre procedimeve penale kanë përfunduar me kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq. Po ti referohemi të dhënave statistikore, rezulton se në krahasim me vitin 2019, ka pasur një ulje me 74 (shtatëdhjetë e katër) procedime penale më pak të dërguara për gjykim.

Rezulton se për vitin 2019, numrin më të madh të çështjeve të dërguara për gjykim e zënë ato të regjistruara për veprën penale “Drejtimi automjeti në mënyrë të pa rregullt” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ndjekur nga vepra penale “Vjedhjes”, parashikuar nga 134 i Kodit Penal, vepra penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuara nga neni 199/a i Kodit Penal, “Dhuna na familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, vepra penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, “Shkelja

<sup>4</sup> Proçedime të regjistruara për vitin 2019

<sup>5</sup> Proçedime të mbartura prej vitit 2018

<sup>6</sup> Referime që nuk kanë marrë numër (në verifikim)

rrregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, vepra penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, vepra penale e “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, si dhe vepra penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

Ajo që vlen të theksohet është se përsa i përket çështjeve penale të regjistruara për veprën penale “Drejtimit mjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, rezulton se mbi 90% të procedimeve penale janë dërguar për gjykim dhe nga këto rreth 45% e këtyre procedimeve penale janë dërguar me gjykim të drejtëpërdrejtë. Raste të pakta janë dërguar me gjykim të zakonshëm dhe këto procedime lidhen kryesisht me seksionin e të miturve, për shkak jo vetëm të mungesës së arrestit në flagrancë por edhe të faktit që një pjesë e këtyre procedimeve dhe personave në hetim apo të pandehur, kanë qënë nga rrethet.

Treguesit e çështjeve penale dhe të pandehurit të dërguara për gjykim janë si më poshtë:

<b>Për nenin 76</b>	1-1 të pandehur -1a.burg	1-1 të pandehur -1a.burg
<b>Për nenin 78</b>	2-5 të pandehur -2 a. Burg	3-5 të pandehur -5 a. Burg
<b>Për nenin 79</b>	2-2 të pandehur -2 a. Burg	5-8 të pandehur -6 a. Burg
<b>Për nenin 89</b>	20-16 të pandehur	14-18 të pandehur
<b>Për nenin 130/a</b>	44-36 të pandehur - 20 a. Burg	58-62 të pandehur - 30 a. Burg
<b>Për nenin 134</b>	76-110 të pandehur - 43 a. Burg	65-86 të pandehur - 33 a. Burg
<b>Për nenin 135</b>	-	-
<b>Për nenin 137</b>	21-21 të pandehur	29-29 të pandehur
<b>Për nenin 139-140-141</b>	4-5 të pandehur -3 a. Burg	3-5 të pandehur -3 a. Burg
<b>Për nenet 172/174</b>	2-2 të pandehur	-
<b>Për nenin 181</b>	-	3-5 të pandehur
<b>Për nenin 186</b>	10-14 të pandehur - 2 a. Burg	7-17 të pandehur
<b>Për nenin 197</b>	2-2 të pandehur	2-2 të pandehur
<b>Për nenin 199/a</b>	51-51 të pandehur	48-8 të pandehur
<b>Për nenin 248</b>	8-14 të pandehur	12-27 të pandehur
<b>Për nenin 259</b>	1-1 të pandehur	1-1 të pandehur
<b>Për nenin 275</b>	1-1 të pandehur	2-2 të pandehur
<b>Për nenin 278</b>	21-21 të pandehur-5 a. Burg	13-13 të pandehur-12 a. Burg
<b>Për nenin 283</b>	39-61 të pandehur-43 a. Burg	37-58 të pandehur-46 a. Burg
<b>Për nenin 284</b>	4-8 të pandehur – 5 a. Burg	9-16 të pandehur – 13 a. Burg
<b>Për nenin 287</b>	3-6 të pandehur	2-3 të pandehur
<b>Për nenin 290</b>	28-28 të pandehur - 19 a. Burg	12-12 të pandehur - 8 a. Burg
<b>Për nenin 291</b>	143-143 të pandehur - 91 a. Burg	90-90 të pandehur - 53 a. Burg
<b>Të tjera</b>	<b>176</b>	<b>169</b>

Duke qënë se disa prej veprave penale të mësipërme, kanë qënë fenomen shqetësues në rreth, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim edhe me policinë gjyqësore, për t'i kushtuar rëndësinë e duhur çështjeve penale që kanë lidhje me veprat e mësipërme, me qëllim që hetimet paraprake në lidhje me këto vepra të jenë sa më të plota, të kryhen në

afate optimale dhe të rritet zbulueshmëria për të vënë para përgjegjësisë penale autorët të cilët janë burim rreziku për shoqërinë.

Gjatë vitit 2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka paraqitur në gjykatë në total 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) ankime për vendime themeli të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

### *II/3. Treguesit kryesor të punës së prokurorisë.*

#### *II/3.1. Të dhënat për vendimet e mosfillimit të procedimit penal.*

Gjatë vitit 2019, rezulton se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 1119 (njëmijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) kallëzime penale, përkundrajt 1195 (njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) vendimeve mosfillimi të marra në vitin 2018.

Një vend të konsiderueshëm në materialet për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit, zënë pikërisht edhe ato që lidhen me veprat penale që ndiqen me ankim ose drejtëpërdrejtë me ankim në gjykatë sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale

Më konkretisht, treguesit e dosjeve të mosfillimit të procedimeve penale në lidhje me veprat penale të trajtuara janë si më poshtë:

	<i>Numri i mosfillimeve</i>	<i>Numri i mosfillimeve</i>
<i>Për nenin 84</i>	108	123
<i>Për nenin 89</i>	95	112
<i>Për nenin 90</i>	54	65
<i>Për nenin 99</i>	49	31
<i>Për nenin 143</i>	52	54
<i>Për nenin 150</i>	91	121
<i>Për nenin 186</i>	39	51
<i>Për nenin 199/a</i>	56	52
<i>Për nenin 200</i>	33	49
<i>Për nenin 248</i>	74	57
<i>Për nenin 290</i>	45	33
<i>Të tjera</i>	423	748

Në përgjithësi është respektuar afati 15 ditor i përcaktuar në ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale për verifikimin e materialit kallëzues dhe marrjen e vendimit në kohë. Sigurisht që konstatohen raste të tejkalimit të këtij afati, por kjo vërehet më shumë në materialet e referuara për nenet 89 të Kodit Penal, vonesë e cila ka ardhur për shkak të akteve të ekspertimit mjekoligjor. Kjo shmangie ka qënë për të mos rritur numrin e materialeve të regjistruara, si dhe duke analizuar nga afër shkaqet e pajustificuara të materialit për regjistrimin e tij si procedim penal.

### *II/3.2 Të dhënat në lidhje me procedimet penale të pushuara.*

Rezulton se gjatë vitit 2019 është vendosur pushimi dhe paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes për 535 (pesëqind e tridhjetë e pesë) procedime penale, të cilat në krahasim me numrin e procedimeve penale të pushuara në vitin 2019, kanë një rritje me 25 (njëzet e pesë) procedime penale. E shprehur në përqindje rezulton se nga numri i çështjeve për vitin 2019 janë pushuar rreth 28% të totalit e çështjeve të përfunduara. Pra rezulton të jetë treguar kujdes në vlerësimin e fakteve dhe provave të administruara gjatë hetimit, dhe kujdes në vlerësimin e materialit që në fazën e kallëzimit dhe referimit të tij.

Mbi bazën e kësaj analize, rezulton të ketë një rritje (në numër të vogël) të çështjeve të pushuara, e cila nga ana tjetër shoqërohet me ulje të materialeve të mosfilluara, në raport me numrin e materialeve të regjistruara dhe trajtuara për vitin 2018.

Përsa i përket veprave penale për të cilat është vendosur pushimi i procedimeve penale, kryesisht i zënë procedimet penale të regjistruara për veprën penale të “Plagosja e lehtë me dashje”, “Falsifikimit të dokumentave”, “Ndërtim i paligjshëm”, “Shpërdorimit të detyrës”, “Kanosjes” dhe “Shkatërrimit të pronës”, të parashikuara nga nenet 89, 186, 199/a, 248, 84 dhe 150 të Kodit Penal.

Sqarojmë se procedimet penale të pushuara për nenin 186 të Kodit Penal, kryesisht kanë rezultuar si fakte të hetuara më parë dhe si pasojë e paraqitjes së të njëjtit kallëzim penal disa herë ndër vite, si dhe për shkaqe të pretenduara të cilat gjatë hetimit kanë rezultuar të pabazuar në prova dhe fakte.

Veprat penale për të cilat është vendosur pushimi i procedimeve janë pak a shumë ato për të cilat është vendosur mosfillimi, ndërsa për shkaqet mund të themi se ato përfshijnë rastet e parashikuara më së shumti prej gërmave “b”, “dh” dhe “d” të nenit 328/1 të K.Pr.Penale.

Më konkretisht, treguesit e çështjeve penale të pushuara, në mënyrë krahasimore me vitin 2018, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Për nenin 76-22	1	-
Për nenin 78	-	-
Për nenin 84	20	13
Për nenin 89	26	32
Për nenin 150	11	13
Për nenin 186	44	33
Për nenin 199/a	43	55
Për nenin 248	46	39
Për nenin 275	12	12
Për nenin 287	12	12

### *II/3.3 Çështjet penale të pezulluara gjatë vitit 2019.*

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri i procedimeve penale të pezulluara përbëjë pjesën më të madhe të procedimeve penale të trajtuara gjatë vitit 2019. Rezulton se gjatë vitit 2019 janë pezulluar për moszbulim të autorëve të veprës penale 755 (shtatëqind e pesëdhjetë e pesë) procedime penale. Ndërsa në total rezulton se janë përfunduar hetimit për

1914 (njëmijë e nëntëqind e katërbëdhjetë) procedime penale. E shprehur në përqindje rezulton se 39.5% e procedimeve të përfunduara janë pezulluar. Nga krahasimi i kësaj të dhëne me vitin 2018, rezulton se për vitin 2019 janë pezulluar 214 (dyqind e katërbëdhjetë) procedime penale më pak, çka tregon se për vitin 2019 është rritur zbulueshmëria e autorëve të veprës penale.

Më konkretisht, treguesit e çështjeve penale të pezulluara në lidhje me veprat penale të trajtuara në to paraqiten si më poshtë;

<b><i>Për nenin 78 të K.P.</i></b>	5	1
<b><i>Për nenin 134</i></b>	541	688
<b><i>Për nenin 150</i></b>	25	49
<b><i>Për nenin 151</i></b>	33	47
<b><i>Për nenin 283</i></b>	15	17
<b><i>Për nenin 284</i></b>	27	8
<b><i>Të tjera</i></b>	109	159

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se numri i çështjeve penale të regjistruara dhe të pezulluara për nenin 134 të Kodit Penal është i konsiderueshëm dhe rritja e kësaj figure bazohet në faktorë socialë dhe ekonomikë. Ashtu siç është theksuar edhe më lart, këto vepra penale i referohen kryesisht vjedhjeve të banesave, celularëve (shtim ky në numër gjatë sezonit turistik), ku identifikimi i autorëve është bërë i vështirë për shkak edhe të mungesës së gjurmëve, apo qoftë edhe mungesës së dyshimeve për persona konkret, por dhe si pasojë e një pune të dobët të shërbimeve të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit.

Treguesit në ulje të procedimeve penale të pezulluara, janë të lidhura ngushtësisht me cilësinë e materialeve referues dhe posaçërisht me veprimet e para hetimore. Pavarësisht kësaj rezulton se duhet një kujdes më i veçantë nga policia gjyqësore në këqyrjet e vendit të ngjarjes, me qëllim fiksimin e gjurmëve. Çmojmë se duhen gjetur rrugë e mënyra të ndryshme, për të afruar informacionin e nevojshëm për autorët dhe gjetjen e mjeteve e metodave ligjore për të kthyer në prova të gjitha të dhënat që administron policia gjyqësore për rastin.

Në shumë raste, veprimet e para hetimore, si këqyrja e vendit të ngjarjes, zbulimi, fiksimi dhe marrja e gjurmëve dhe provave materiale që kanë lidhje me zbulimin e mekanizmit dhe autorëve, kanë qenë jo të plota dhe të kryera në mënyrë jo profesionale. Kryerja e këtyre veprimeve me përpikmëri dhe përgjegjësi do të çonte në hetimin e plotë të ngjarjes dhe zbulimin dhe vënien para përgjegjesisë penale të autorëve të kryerjes së veprës.

### ***II/3.4 Çështjet penale të transferuara gjatë vitit 2019.***

Rezultoni se gjatë vitit 2019 është shpallur moskompetenca për 39 (tridhjetë e nëntë) procedime penale, kryesisht për mungesë kompetencë territoriale dhe lëndore, kurse nga Prokurorit e tjera kanë ardhur 121 ( njëqind e njëzet e një ) procedime penale.

### *III/3.5 Çështjet penale të dërguara për gjykim.*

Gjatë vitit 2019 janë dërguar për gjykim 585 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë) procedime penale me 707 (shtatëqind e shtatë) të pandehur. Në raport me procedimet e përfunduara për vitin 2019, rezulton se mbi 30.5% e këtyre procedimeve penale kanë përfunduar me kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq. Po ti referohemi të dhënave statistikore, rezulton se në krahasim me vitin 2018, ka pasur ulje me 74 (shtatëdhjetë e katër) procedime penale me pak të dërguara për gjykim.

Treguesit e çështjeve penale dhe të pandehurit të dërguara për gjykim janë si më poshtë:

<b>Për nenin 76</b>	1-1 të pandehur -1a.burg
<b>Për nenin 78</b>	3-5 të pandehur -5 a. Burg
<b>Për nenin 79</b>	5-8 të pandehur -6 a. Burg
<b>Për nenin 89</b>	14-18 të pandehur
<b>Për nenin 130/a</b>	58-62 të pandehur - 30 a. Burg
<b>Për nenin 134</b>	65-86 të pandehur - 33 a. Burg
<b>Për nenin 135</b>	-
<b>Për nenin 137</b>	29-29 të pandehur
<b>Për nenin 139-140-141</b>	3-5 të pandehur -3 a. Burg
<b>Për nenet 172/174</b>	-
<b>Për nenin 181</b>	3-5 të pandehur
<b>Për nenin 186</b>	7-17 të pandehur
<b>Për nenin 197</b>	2-2 të pandehur
<b>Për nenin 199/a</b>	48-8 të pandehur
<b>Për nenin 248</b>	12-27 të pandehur
<b>Për nenin 259</b>	1-1 të pandehur
<b>Për nenin 275</b>	2-2 të pandehur
<b>Për nenin 278</b>	13-13 të pandehur-12 a. Burg
<b>Për nenin 283</b>	37-58 të pandehur-46 a. Burg
<b>Për nenin 284</b>	9-16 të pandehur – 13 a. Burg
<b>Për nenin 287</b>	2-3 të pandehur
<b>Për nenin 290</b>	12-12 të pandehur - 8 a. Burg
<b>Për nenin 291</b>	90-90 të pandehur - 53 a. Burg
<b>Të tjera</b>	<b>169</b>

### *III/4. Të dhënat në lidhje me njoftimet për veprat penale.*


Përsa i përket burimit të referimit të çështjeve penale të regjistruara dhe të trajtuara gjatë vitit 2019, rezulton se materialet janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore, nëpunësit publikë/institucionet, si dhe kallëzime nga shtetasit. Më konkretisht treguesit e burimeve të referimit të çështjeve penale të regjistruara gjatë vitit 2019 janë:

	2019	2018
Të regjistruara kryesisht	51	38
Kallëzime nga nëpunësit publikë/institucionet	93	80
Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit	-	-
Nga ILDKP	-	1
Sektori i Verifikimit Integritetit për Personat e Zgjedhur	2	3
Nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave (FIU)	-	-
Nga Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH)	-	-
Nga Personeli mjekësor	-	-
Nga Drejtoria e Tatim Taksave + Dogana	11	-
Kallëzime nga shtetas	245	246
Nga policia me vendngjarje	884	1210
Nga policia me kallëzim të shtetasve	1907	1976
Nga policia pyjore	-	-
Nga OSHEE	-	117
Nga IMT- IKMT.	33	-
Të tjera	10	-

Krahasuar me vitin 2018, rezulton se në vitin 2019 numri i kallëzimeve të shtetasve është përafërsisht i barabartë, çka tregon për rritjen e besimit të publikut tek organi i prokurorisë. Ndërsa në lidhje me veprat penale me vendngjarje, krahasuar me ato të vitit 2018, rezulton një ulje, e konkretisht 293 (dyqind e nëntëdhjetë e tre) raste më pak.

Në vitin 2019, rezulton se referimet për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike”, janë kryer nga oficerët e policisë gjyqësore në Komisaratin e Policisë Vlorë.

Po kështu edhe përsa i përket veprës penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, rezulton se referimet e veprës penale kanë ardhur si pasojë e njoftimeve nga qytetarë në sallën operative apo përmes kallëzimeve të tyre në Komisaratin e Policisë Vlorë (duke përfshirë Himarë dhe



Selenicë). Në lidhje me këtë vepër penale rezulton se ka pasur edhe kallëzime penale të paraqitura nga IMT pranë Bashkisë Vlorë dhe IMT pranë Bashkisë Himarë.33 (tridhjetë e tre dhe nga Drejtoria e Tatimeve 11 ( njëmbëdhjetë). Përsa i përket procedimeve penale të regjistruara kryesisht, rezulton se për gjatë vitit 2019 është regjistruar 1 (një) procedim penal kryesisht, si dhe 47 (dyzet e shtatë) procedime penale mbi bazën e vendimit të ndarjes së çështjes.

Ndërkohë që ka pasur vetëm 7 (shtatë) procedime penale të regjistruara për veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak.

Në këndvështrim të figurave të veprave penale konkrete për të cilat janë regjistruar procedimet penale për vitin 2019, rezulton si më poshtë:

Nr. i Procedimeve	Neni për te cilin janë	11	Për nenin 189
1	Për nenin 76	6	Për nenin 190
6	Për nenin 78	2	Për nenin 197
5	Për nenin 79	142	Për nenin 199/a
28	Për nenin 84	10	Për nenin 200
9	Për nenin 88	14	Për nenin 236
69	Për nenin 89	12	Për nenin 242
7	Për nenin 96	49	Për nenin 248
-	Për nenin 90	7	Për nenin 259
4	Për nenin 100	4	Për nenin 273
1	Për nenin 109	23	Për nenin 275
4	Për nenin 114	15	Për nenin 277
11	Për nenin 121/a	28	Për nenin 278
2	Për nenin 124	9	Për nenin 279
-	Për nenin 124/b	1	Për nenin 280
81	Për nenin 130/a/1/2/3/4	56	Për nenin 283
786	Për nenin 134	80	Për nenin 284
66	Për nenin 137	19	Për nenin 287
3	Për nenin 139	7	Për nenin 289
24	Për nenin 141/a	56	Për nenin 290
50	Për nenin 143	113	Për nenin 291
63	Për nenin 150	52	Për nenin 297
56	Për nenin 151	6	Për nenin 300
7	Për nenin 152	9	Për nenin 305
3	Për nenin 159	6	Për nenin 320
5	Për nenin 170/a	13	Për nenin 321
12	Për nenin 180	3	Për nenin 323
7	Për nenin 183	52	Për nene të tjera
63	Për nenin 186		

### *III/5 Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror.*

#### *III/5.1 Treguesit e masave të sigurimit personal.*

Gjatë vitit 2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë referuar në funksion të procedimeve penale të regjistruara 321 (treqind e njëzet e një) raste të personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar. Për personat e arrestuar dhe ndaluar, nga ana e prokurorëve është urdhëruar lirim i menjëhershëm në 3 (tre) raste dhe në 318 (treqind e tetëmbëdhjetë) raste janë dërguar aktet në gjykatë për vleftësim arresti në flagrancë/ndalimi dhe është kërkuar në 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) raste caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, në 13 (trembëdhjetë) raste është kërkuar masa e sigurimit arrest me burg në mungesë, në 8 (tetë) raste është kërkuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi), në 5 (pesë) raste është kërkuar masa e sigurimit arrest në burg me afat, si dhe në 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) raste është kërkuar masa e sigurimit detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore.

Në lidhje me kërkesat e mësipërme rezulton se nga gjykata është pranuar kërkesa dhe është caktuar masa e sigurimit arrest në burg për 184 (njëqind e tetëdhjetë e katër) raste, ku në të gjitha rastet kur është kërkuar masa e sigurimit arrest në burg në mungesë, gjykata e ka pranuar kërkesën e prokurorit. Ndërsa në 20 (njëzet) raste është caktuar masa e sigurimit arrest në shtëpi, për 9 (nëntë) raste është caktuar masa e sigurimit arrest në burg me afat dhe në 92 (nëntëdhjetë e dy) raste është caktuar masa e sigurimit detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore. Ndërsa nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se vetëm në 7 (shtatë) raste është konsideruar arrestimi apo ndalimi i paligjshëm.

Përsa i përket rasteve kur është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg”, rezulton se përgjithësisht janë rastet e procedimeve penale të regjistruara për nenin 291 të Kodit Penal, ku së bashku me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit është kërkuar edhe gjykimi i drejtëpërdrejtë i saj, si dhe për veprat penale kundër jetës dhe në fushën e lëndëve narkotike. Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, nga gjykata ka pasur dy qëndrime në caktimin e masës së sigurimit, duke aplikuar masën e sigurimit detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore dhe jo masën e kërkuar nga prokurori. Ndoshta qëndrimi i gjykatës në aplikim të masës së sigurimit detyrim për paraqitje ka qënë ngushtësisht i lidhur edhe me masën e dënimit të dhënë prej saj, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal apo edhe atë të kryerjes së një pune publike, sipas nenit 63, dhe 53/a të Kodit Penal. Theksohet këtu se përsa i përket konsumimit të kësaj vepre penale nga të miturit, ata ose janë ndjekur në gjëndje të lirë ose me masë sigurimi detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore.

Po kështu duke iu referuar faktit se numrin më të madh të çështjeve të dërguara për gjykim e zë pikërisht vepra penale e “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, për këto raste qëndrimi i gjykatës ka qënë mbështetës në zbatimin e masës së sigurimit shtrënguese arrest në burg.

Masat e sigurimit si “Arrest në shtëpi” apo masë sigurimi “arrest në burg me afat”, është aplikuar kryesisht nga organi procedues në raste e veprave penale të regjistruara për nenin 290 të Kodit Penal , kur është vlerësuar se duhet të administrohet akti ekspertimi mjekoligjor, apo në disa raste të rralla edhe akti i ekspertimit autoteknik. Në lidhje me lirimet e menjëhershme gjithashtu bëhet fjalë për veprat penale të regjistruara për nenin 290 “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”. Në fakt në këto raste është urdhëruar lirimi që në fazën e parë të hetimit, sapo është vënë në dispozicion të organit procedues referimi mbi arrestimin e kryer.

Në analizë sa më sipër rezulton se në rreth 85% të rasteve është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg”.

Treguesit e masave të sigurimit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

<i><b>Totali i arrestimeve/ ndalimeve</b></i>	<i><b>Lirim i menjëhershëm Neni 257</b></i>	<i><b>Kërkesa e prokurorisë Neni 258 K.Pr.P</b></i>	<i><b>Vendimi i gjykatës Neni 259</b></i>
321	3	318	318
<i>Vleftësime të ligjshme</i>		318	311
<i>Vleftësime të paligjshme</i>			7
<i>Arrest në burg</i>		216	181
<i>Arrest me afat</i>		5	9
<i>Arrest në shtëpi</i>		8	20
<i>Detyrim paraqitje</i>		76	92
<i>Garanci pasurore</i>			3
<i>Arrest në mungesë</i>		13	13

### *II/5.2 Treguesit e masave të sigurimit pasuror.*

Për Vitin 2019 janë kërkuar sekuestro preventive të parashikuar nga neni 274 të K.Pr.Penale, kryesisht për procedime penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Rezulton se gjatë vitit 2019, në kuadër të procedimeve penale të ndryshme me vendim gjykata është vendosur masa e sekuestros preventive mbi pasuritë e mëposhtme<sup>7</sup>:

1. Të pasurisë së paluajtshme 3 (tre) objekte dy katëshe në mënyrë të barabartë, gjithsej 432 m<sup>2</sup> secili, të ndërtuara mbi një shesh ndërtimi prej 2000 m<sup>2</sup>, ZK 3467, objekte të cilat janë vlerësuar nga eksperti në shumën prej 39.070.512 lekë.
2. Automjeti i llojit autoveturë, me vlerë 3.500 Euro.
3. Të shumës prej prej 22,523.68 Euro, të depozituara bankë.
4. Të shumës prej prej 45,011 Euro, të depozituara në bankë.
5. Të shumës prej prej 77,378.51 Euro, të depozituara në bankë.
6. Të shumës prej prej 15,153.58 Euro, të depozituara në bankë.
7. Të shumës prej prej 1,531,522.37 lekë, të depozituara në bankë.
8. Të shumës prej prej 3,012.70 Euro, të depozituara në bankë.
9. Të shumës prej prej 6,034.19 Euro, të depozituara në bankë.
10. Të shumës prej prej 30,070 Euro lekë, të depozituara në bankë.
11. Pasurisë së paluajtshme e llojit njësi shërbimi me sipërfaqe 50.5 m<sup>2</sup>, që ndodhet në ZK 8603, Vlorë, në vlerën prej 5.252.000 Lekë.
12. Pasurisë së paluajtshme që ndodhet në ZK 3140, Vlorë, në vlerën prej 4.200.000 Lekë.
13. Pasurisë së paluajtshme e llojit apartament nr. 8, i përbërë nga 1+1, në vlerën prej 25.000 Euro.
14. Pasurisë së paluajtshme e llojit apartament banimi të tipit 36, me sipërfaqe 120.2 m<sup>2</sup>, në vlerën prej 42.000 Euro.

<sup>7</sup> Për efekt sekreti hetimor nuk citohen të dhënat e personave pronarë/pseudues dhe të dhënat e plota të pasurive.

15. Të shumës prej 709,251.27 Lekë, të depozituara në bankë.
16. Të shumës prej 20,059.55 Euro, të depozituara në bankë.
17. Të automjetit me targa \_\_\_\_\_, në vlerën prej 3.000 Euro.
18. Të automjetit me targa \_\_\_\_\_, në vlerën prej 130.000 Lekë.
19. Pasuria nr. 31/41-N1 ZK, njësi me sip. 197 m<sup>2</sup>, në vlerën e 16.744.606 Lekë.
20. Pasuria nr. 31/41+1-35, ZK 8602, apartament, me sip 104 m<sup>2</sup>.
21. Pasuria nr. 31/41+1-34 ZK 8602, apartament me sip 75 m<sup>2</sup>, në vlerën 3.187.500 Lekë.
22. Pasuria nr. 31/48-N8 ZK 8602, njësi shërbimi me sip 22 m<sup>2</sup> në vlerën e 1.869.956 Lekë.
23. Pasuria nr. 31/41+1-39 ZK 8602, apartament me sip 60 m<sup>2</sup> në vlerën e 3.642.000 Lekë.
24. Pasuria nr. 31/41+1-36, ZK 8602, apartament me sip 70 m<sup>2</sup>, në vlerën e 4.290.000 Lekë.
25. Pasurinë nr. 31/41-N6 ZK 8602, njësi me sip 35 m<sup>2</sup>, në vlerën e 3.200.000 Lekë.
26. Pasuri nr. 31/41 -N2 ZK 8602, njësi me sip 20 m<sup>2</sup>, në vlerën e 1.830.000 Lekë.
27. Pasuria nr. 31/41+1-50 ZK 8602, apartament me sip 81 m<sup>2</sup>.
28. Pasuria nr. 31/41-N7 ZK 8602, njësi shërbimi me sip 25 m<sup>2</sup>, në vlerën e 16.000 Euro.
29. Pasuria nr. 31/41-N5 ZK 8602, me sip 35 m<sup>2</sup>, me vlerën e 22. 000 Euro.
30. Objekti informal, ndërtesë tre kate karabina, me sip baze 150 m<sup>2</sup>, me sip totale 450 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin Kaninë Vlorë.
31. Autoveturë markës Mercedes Benz 250 D, me targë \_\_\_\_\_, prodhim i vitit 1988.
32. Autoveturë markës Volkswagen Tiguan me targë \_\_\_\_\_.
33. Autoveturë markës Iveco -frigoriferike me targë \_\_\_\_\_, viti prodhimit 2002.
34. Autoveturë markës Peugeot me targë \_\_\_\_\_, prodhim vitit 2000.
35. Mjeti lundrues anije peshkimi me emrin "X\_\_\_\_\_".
36. Pasuria me Nr.13/8/1, zk.8605, me sipërfaqe prej 2590m<sup>2</sup>.

### *III/6 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.*

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për ekzekutimin e vendimeve penale gjatë vitit 2019 ka funksionuar seksioni përkatës, me prokuror të këtij seksioni z. Xhemal Saliq dhe O.P.Gj. znj. Ariela Rexha.

Gjatë vitit 2019 rezulton se janë nxjerrë në total 652 (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) urdhëra ekzekutimi, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë. Nga këto urdhëra rezulton se 113 (njëqind e trembëdhjetë) prej tyre janë nxjerrë për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës për dënimet me burgim, përfshirë këtu edhe dënimet në mungesë. Numri i urdhërave të ekzekutimit për dënimet me gjobë është 55 (pesëdhjetë e pesë) urdhëra dhe rezulton se nga ky seksion janë nxjerrë 381 (treqind e tetëdhjetë e një) urdhëra për shërbimin e provës në total. Rezulton se 36 (tridhjetë e gjashtë) urdhëra janë nxjerrë për neni 63 të Kodit Penal, si dhe 70 (shtatëdhjetë) urdhëra janë nxjerrë për disponimin e provave materiale dhe shpenzimeve proceduriale

Në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale problematika kryesore është e lidhur me adresat e të dënuarve. Vështirësi ka patur gjatë fazës së ekzekutimit ndjekja e përmbushjes së dënimit alternativ që kanë të bëjnë me shkollimin, punësimin, mos largimin nga vendi i banimit, mospërdorimin e pijes alkolike apo lëndëve narkotike, mos shoqërimi me persona të dënuar etj. Ndjekja e kësaj faze ekzekutimi kërkon një

bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë të punës midis Shërbimit të Provës, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë. Gjithashtu, rezulton se ka lindur një problematikë në lidhje me ekzekutimin e dënimeve alternative sipas nenit 59 të Kodit Penal, për shkak se periudha e provës e sanksionuar në vendim ka kaluar në momentin e marrjes së vendimit formë të prerë.

Rezulton se për gjatë vitit 2019 janë paraqitur në gjykata 125 (njëqind e njëzet e pesë) kërkesa për revokimin e dënimit alternativ të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

### **III/7. Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë.**

Referuar materialeve të regjistruara rezulton se numri më i madh veprave penale të konsumuara i përkasin territorit të njësisë administrative Bashkia Vlorë, kjo për shkak të numrit më të madh të banorëve dhe territorit që mbulon kjo njësi. Në vend të dytë përse u përket veprave penale të referuara/kallëzuara është njësia administrative Bashkia Himarë me rreth 12 % të totalit të çështjeve të referuara/kallëzuara, ku rezulton se numri i veprave penale rritet përgjithësisht gjatë sezonit turistik. Ndërsa në vend të tretë përse i përket përhapjes së kriminalitetit është njësia administrative Bashkia Selenicë. Në total veprat e referuara/kallëzuara për gjatë vitit 2019 për Bashkinë Vlorë dhe Selenicë janë në masën mbi 80% e referimeve/kallëzimeve.

### **III/8 Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre.**

Referuar materialeve të regjistruara rezulton se vepra penale e “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, zë peshën më të madhe të procedimeve penale të hetuara, me gjithsej 686 (gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) procedime të regjistruara. Ndërsa për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal janë regjistruar 113 (njëqind e trembëdhjetë) procedime penale, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a të Kodit Penal janë regjistruar 142 (njëqind e dyzet e dy) procedime penale, për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal janë regjistruar 63 (gjashtëdhjetë e tre) procedime penale, për veprën penale të parashikuar nga neni 283 janë regjistruar 56 (pesëdhjetë e gjashtë) procedime penale, për nenin 290 të Kodit Penal janë regjistruar 56 (pesëdhjetë e gjashtë) procedime penale dhe për nenin 89 të Kodit Penal janë regjistruar 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) procedime penale.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se peshën më të madhe të procedimeve penale e zënë veprat penale kundër pasurisë, vepër kjo e përhapur në të gjitha njësitë administrative. Ndërsa përse u përket veprave penale të parashikuara nga neni 199/a i Kodit Penal, rezulton se kjo vepër është më e përhapur në Bashkinë Vlorë dhe në Bashkinë Himarë. Përse u përket veprave penale të parashikuara nga nenet 290 dhe 291 të Kodit Penal, rezulton se këto vepra penale janë më të përhapura në Bashkinë Vlorë. Në lidhje me tendencat e kriminalitetit konstatohet rritje e numrit të veprave penale kundër pasurisë, si dhe të veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike.

### III/9 Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal.

Në këndvështrim të figurave të veprave penale konkrete për të cilat janë regjistruar procedimet penale për vitin 2019, rezulton si më poshtë:

1	Për nenin 76	9	Për nenin 189
2	Për nenin 78	5	Për nenin 190
1	Për nenin 79	2	Për nenin 197
2	Për nenin 84	1	Për nenin 199/a
9	Për nenin 88	1	Për nenin 200
6	Për nenin 89	1	Për nenin 236
6	Për nenin 96	1	Për nenin 242
6	Për nenin 90	4	Për nenin 248
2	Për nenin 100	7	Për nenin 259
1	Për nenin 109	4	Për nenin 273
4	Për nenin 114	2	Për nenin 275
8	Për nenin 121/a	1	Për nenin 277
1	Për nenin 124	2	Për nenin 278
-	Për nenin 124/b	5	Për nenin 279
6	Për nenin	1	Për nenin 280
6	Për nenin 134	4	Për nenin 283
6	Për nenin 137	8	Për nenin 284
3	Për nenin 139	1	Për nenin 287
2	Për nenin 141/a	7	Për nenin 289
4	Për nenin 143	4	Për nenin 290
6	Për nenin 150	1	Për nenin 291
5	Për nenin 151	4	Për nenin 297
7	Për nenin 152	5	Për nenin 300
3	Për nenin 159	9	Për nenin 305
5	Për nenin 170/a	6	Për nenin 320
1	Për nenin 180	9	Për nenin 321
7	Për nenin 183	3	Për nenin 323
6	Për nenin 186	2	Për nene të tjera

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se janë regjistruar gjithsej 2178 (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) procedime penale, nga të cilat 1912 (njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) për krime dhe 266 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) për kundërvajtje penale. Pra, rezulton se numrin me të lartë të procedimeve penale të regjistruara e zënë krimet.

## II. TREGUESIT STATISTIKORË 2 VJEÇARË TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL.

Të dhënat statistikore në formë tabelle:

	<i>Nr. procedimeve te regjistruara</i>	<i>Nr. procedimeve te dërguar për Gjykim</i>	<i>Nr. i pand. dhe nen hetim</i>	<i>Nr. i pand. dërguar për gjykim</i>	<i>Nr. i te pand. te dënuar</i>
<i>Viti 2019</i>	2178	585	943	707	611
<i>Viti 2018</i>	2445	659	1197	807	738

## IV. ANALIZA E TREGUESVE TE EFEKTIVITETIT TE PROKURORISË

### IV/1 Treguesit e efektivitetit në gjykimin dhe dënimeve të të pandehurve.

Gjatë vitit 2019 janë marrë të pandehur gjithsej 867 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) shtetas, nga të cilët 707 (shtatëqind e shtatë) të pandehur janë dërguar për gjykim në kuadër të 585 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë) procedimeve penale.

Nga këto procedime penale dhe të pandehur të dërguar për gjykim rezulton se ka përfunduar gjykimi për 518 (pesëqind e tetëmbëdhjetë) procedime penale me 611 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë) të pandehur. Ndërsa pjesa tjetër e procedimeve dhe të të pandehurve së bashku dhe me të mbarturat nga viti 2018, rezulton se vazhdojnë të jenë në gjykim për vitin 2020. Për gjatë vitit 2019 rezulton se për 28 (njëzet e tetë) procedime penale dhe 30 (tridhjetë) të pandehur është dhënë vendim pafajësie. Në raport me procedimet e përfunduara për vitin 2019, rezulton se mbi 30.5% e këtyre procedimeve penale kanë përfunduar me kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq. Po ti referohemi të dhënave statistikore, rezulton se në krahasim me vitin 2018, ka pasur ulje me 74 (shtatëdhjetë e katër) procedime penale më pak të dërguara për gjykim.

Pafajësitë e dhëna për vitin 2018 paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

- Për nenin	78	1 pandehur
- Për nenin	190	1 pandehur
- Për nenin	130/a	6 pandehur
- Për nenin	134	3 pandehur
- Për nenin	137	2 pandehur
- Për nenin	143	2 pandehur
- Për nenin	186	2 pandehur
- Për nenin	190	1 pandehur
- Për nenin	199/a	2 pandehur
- Për nenin	248	2 pandehur
- Për nenin	151	1 pandehur

- Për nenin	170/a	1 pandehur
- Për nenin	273	1 pandehur
- Për nenin	290/3	1 pandehur
- Për nenin	278/1	1 pandehur
- Për nenin	277	1 pandehur
- Për nenin	283	1 pandehur
- Për nenin	288/a/1	1 pandehur

Për shumë nga rastet e pafajësive vazhdojmë të mbetemi konstant në qëndrimet tona para gjykatës sigurisht duke analizuar çdo qëndrim apo kërkesë tonën dhe çdo qëndrim apo arsyetim të gjykatës, në mënyrë të tillë që ti japim mbështetjen dhe vëmendjen e duhur çdo rasti dhe praktike në respektim të mbrojtjes të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për të gjitha rastet është mbajtur qëndrimi ligjor duke ankimuar vendimet e gjykatës.

#### *IV/2. Të dhënat për gjykimet e posaçme.*

Rezulton se për gjatë vitit 2019, nga prokurorët janë përdorur institutet procedurale si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, si dhe gjykimi i drejtëpërdrejtë. Rezulton se për 54 procedime penale me 54 të pandehur nga prokurorët janë nxjerrë urdhra penal. Ndërsa për 49 procedime penale me 49 të pandehur, rezulton se është hartuar marrëveshja e fajësisë, ku nga ana e Gjykatës vetëm për kaq 4 raste me 4 të pandehur është vendosur mospranimi i marrëveshjes. Rezulton se për 40 procedime penale me 40 të pandehur është operuar me ritin e gjykimin të drejtëpërdrejtë, ku rezulton se nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorit.

Më konkretisht treguesit e gjykimin të çështjeve penale janë si më poshtë ;

<b>2019</b>	<i>518 – 611 të pandehur</i>	<i>40 – 40 të pandehur</i>	<i>49 – 49 të pandehur</i>	<i>54 – 54 të pandehur</i>	<i>410 – 489 të pandehur</i>	<i>47- 61 të pandehur</i>	<i>21 –21 të pandehur</i>
-------------	------------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	------------------------------	---------------------------	---------------------------

#### *IV/3. Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve.*

Gjatë vitit 2019, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë përfunduar gjykimet për 518 (pesëqind e tetëmbëdhjetë) çështje penale me 611 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë) të pandehur. Nga totali i çështjeve të gjykuara, nga ana e organit të prokurorisë gjatë vitit 2019, është kërkuar dënimi i të pandehurve me gjobë në 59 (pesëdhjetë e nëntë) raste, pushim çështje në 9 (nëntë) raste, për 11 (njëmbëdhjetë) raste është kërkuar dënim në minimum, ndërsa në rastet e tjera është kërkuar dënim me burgim. Rezulton se për 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) raste është kërkuar nga prokurorët pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe vënia në provë, raste të cilat i referohen më së

shumti çështjeve me të pandehur të mitur, për arsye të politikës së ndjekur për këtë kategori personash, si dhe veprave penale dhe autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore.

Të dhënat mbi llojet dhe masat e dënimit paraqiten në tabelën si më poshtë:

<i>Llojet e dënimeve</i>	<i>Kërkesa e prokurorisë</i>	<i>Vendimi i gjykatës</i>
<i>Dënim me gjobë</i>	59	59
<i>Dënim me burgim (minimum)</i>	11	10
<i>Dënim me burgim (mesatar)</i>	405	318
<i>Dënim me burgim (maksimal)</i>	4	2
<i>Paraburgim</i>	7	0
<i>Pezullim ekzekutimi dënimi 59</i>	116	187
<i>Burgim të përjetshëm</i>		
<i>Tërheqje aktesh</i>	0	0
<i>Pushim çështje</i>	9	5
<i>Pafajësi</i>	-	30

#### *IV/4 Të dhënat sociale dhe demografike për të pandehurit.*

Në lidhje me të dhënat demografike dhe sociale të të pandehurve të cilët janë gjykuar rezultojnë se:

- 611 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë) të pandehur janë të rritur nga të cilët 529 (pesëqind e njëzet e nëntë) meshkuj dhe 22 (njëzet e dy) femra.
- Për sa i përket arsimit deri në 9 klasë, rezultojnë se janë 176 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) të pandehur janë me arsim 9 klasë.
- Rezultojnë se 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) të pandehur janë me arsim të mesëm dhe 39 (tridhjetë e nëntë) të pandehur janë me arsim të lartë.
- Përsa i përket punësimit, rezultojnë se 395 (treqind e nëntëdhjetë e pesë) të pandehur janë te papunë, 189 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë) të pandehur janë të punësuar në sektorin privat, si dhe 27 (njëzet e shtatë) të pandehur janë specialistë të ndryshëm.

#### *IV/5. Të dhënat për të pandehurit e mitur.*

Gjatë vitit 2019 Seksioni i të Miturve dhe ekzekutimet ka patur në përbërje të tij, tre prokurorë, e konkretisht z. Dritan Marku (drejtues seksioni), z. Xhemal Saliaj dhe z. Saimir Smaka dhe oficeri i policisë gjyqësore znj. Ariela Rexha.

Nga ana e organit të akuzës është mbajtur parasysh në caktimin e dënimit për të miturit të gjitha konventat, ligjet, udhëzimet, në lidhje me kujdesin që duhet të tregohet ndaj tyre.

Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar caktimit të masave të sigurimit. Gjithashtu edhe në kërkesat për masë dënimi është mbajtur

parasysh fakti se subjektet janë persona të mitur dhe lloji dhe masa e dënimit të dhënë ka qënë gjithnjë e kushtëzuar nga ky fakt dhe sigurisht ka patur për bazë parashikimet ligjore për veprën e kryer. Qëndrim i ashpër është mbajtur për të miturit që kanë rezultuar përsëritës dhe për rastet kur vepra është kryer në rrethana të cilësuar. Gjithashtu, rezulton se në 31 (tridhjetë e një) procedime penale janë marrë masa alternative duke shmangur të miturin në konflikt me ligjin nga përgjegjësia penale.

Më konkretisht treguesit e ngarkesës së punës së Seksionit të të Miturve janë si më poshtë:

<b>2019</b>	<b>142</b>	<b>29</b>	<b>113</b>	<b>52</b>	<b>42</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>48</b>	<b>-</b>
<b>2018</b>	<b>152</b>	<b>32</b>	<b>120</b>	<b>42</b>	<b>40</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>80</b>	<b>21</b>

Ajo që vihet re në trajtimin e çështjeve penale me të mitur është fakti se pjesa më e madhe e çështjeve të rregjistruara kanë qënë kryesisht për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, si dhe “Drejtim mjete në mënyrë të pa rregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

#### *IV/6. Të dhënat për pasojat e veprave penale.*

Referuar natyrës së veprave penale të procedimeve penale të regjistruara për vitin 2019, konstatohet se pjesën më të madhe e zënë vepra penale që kane sjellë dëm ekonomik ku përfshin të gjitha veprat penale kundër pasurisë (rreth 65%), kurse vepra penale me pasojat cënimin e jetës dhe shëndetit janë rreth 25%, etj.

### **V. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETIT E HUAJA**

Gjatë vitit 2019, është kërkuar në 8 (tetë) raste ekstradimi për jashtë shtetit, si dhe në 5 (pesë) raste rezulton se është paraqitur kërkesë për ekstradim nga jashtë shtetit.

Rezulton se ka patur një ngarkesë të konsiderueshme pune në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja dhe konkretisht gjatë këtij viti i janë dërguar autoriteteve gjyqësore kompetente 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale, ndërkohë që janë dërguar prej autoritetet gjyqësore të huaja në drejtim të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale. Po kështu, rezulton se për këtë vit janë kërkuar 8 (tetë) njohje vendimi penal të huaja, për të cilat në 2 (dy) raste është pranuar kërkesa për njohje, në 3 (tre) raste është rrëzuar kërkesa dhe 3 (tre) raste të tjera janë në proces gjyqësor. Rezulton se në të gjitha rastet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka miratuar kërkesën për ekstradimin.

Përsa i përket shpalljes në kërkim ndërkombëtar rezulton se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, janë nxjerrë 16 (gjashtëmbëdhjetë) urdhëra për shpallje

në kërkim ndërkombëtar dhe janë nxjerrë 7 (shtatë) urdhëra për heqje nga kërkimi ndërkombëtar.

Konstatohet një korrektësi maksimale në raport me autoritetet gjyqësore të huaja në përmbushjen e detyrimeve ligjore, në një kohë kur pritet që edhe autoritet e huaja gjyqësore të na përgjigjen me të njëjtën shkallë korrektësie.

*V/2 Letërporosi nga jashtë.*

Rezulton se nga autoritetet e huaja janë paraqitur 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa për ndihmë juridike që konsistojnë në njoftim të dëshmitareve, njoftimin e përfundimit të hetimeve, si dhe kryerjen e veprimeve proceduariale dhe administrimin e provave.

Ndërsa nga prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë dërguar 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa për letërporosi për jashtë, që konsistojnë në marrjen e të dhënave, si dhe kryerjen e veprimeve proceduariale dhe administrimin e provave, etj. Rezulton se letërporositë janë hartuar kryesisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 141/a dhe 287 të Kodit Penal.

*V/3 Njohja e vendimeve penale të huaja.*

Rezulton se në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është kërkuar njohja e 8 (tetë) vendimeve penale të huaja. Për 2 (dy) raste është pranuar kërkesa për njohje, në 3 (tre) raste është rrëzuar kërkesa dhe 3 (tre) raste të tjera janë në proces gjyqësor.

*V/4 Transferime të procedimeve penale.*

Rezulton se gjatë vitit 2019 nuk është transferuar ndonjë procedim penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

*V/5 Transferimet e personave të dënuar.*

Rezulton se gjatë vitit 2019 nuk është transferuar ndonjë i dënuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.


*V/6 Shpalljet në kërkim ndërkombëtar.*

Për gjatë vitit 2019 është proceduar me nxjerrjen e 16 (gjashtëmbëdhjetë) urdhërave për shpalljen në kërkim ndërkombëtar dhe 7 (shtatë) urdhëra janë nxjerrë heqjen nga kërkimi ndërkombëtar.

## VI. NGARKESA E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

Gjatë vitit 2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka pasur një ngarkesë të konsiderueshme pune si përsa i përket hetimit ashtu edhe përfaqësimit të çështjeve në gjykim. Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të dhënat e ngarkesës së prokurorëve në fazën e hetimeve paraprake dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

Nr.	Prokurori	Mosf.	Kall. të mbartur	Pushim	Pezull	Transf.	Gjyq	Hetim	Procedime Gjithsej
1	E.ÇELA	88	0	6	29	1	20	4	60
2	A.KULICI	54	3	56	15	0	25	61	157
3	E.LAZE	40	2	15	30	0	38	52	135
4	A.SALI	115	9	46	83	2	48	61	240
5	D.MARKU	120	7	55	46	6	102	32	241
6	A.PALI	66	8	32	13	1	33	114	193
7	A.XHAFERRAJ	26	3	35	36	1	29	146	247
8	A.ZARKA	59	8	19	52	3	24	85	183
10	E.ALVORA	78	2	34	14	3	7	70	128
18	E.MUSTAJ	25	3	14	17	1	13	58	103
11	E.SHQARRI	5	1	1	5	0	0	86	92
12	E.VISOÇI	20	8	13	8	0	5	64	90
13	F.CELA	106	4	29	118	5	51	47	250
14	H.LAMAJ	81	4	43	109	4	49	67	272
15	K.LLAHO	119	5	62	98	0	68	117	345
16	M.SOTA	11	0	2	15	1	5	0	23
17	S.SMAKA	106	0	73	67	11	68	81	300
18	XH.SALIAJ	0	0	0	0	0	0	6	6
		1119	67	535	755	39	585	1151	3065




Ne vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 rezulton se ngarkesa për çdo prokuror ka një mesatare më të lartë, ne raport kjo edhe me organikës përkatëse.

Për vitin 2019 janë përfunduar në gjykim 518 (pesëqind e tetëmbëdhjetë) çështje penale, pa përmendur dhe çështje që janë ndjekur drejtpërdrejt në gjykatë dhe çështjet e parashkuara të ndara sipas prokurorëve, statistikave të çështjeve të gjykuara janë të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

<i>NR.</i>	<i>Prokurori</i>	<i>Çështje te gjykuara</i>
1.	<b>E.CELA</b>	6
2.	<b>A.KULICI</b>	15
3.	<b>E.LAZE</b>	35
4.	<b>A.SALI</b>	51
5.	<b>D.MARKU</b>	146
6.	<b>A.PALI</b>	23
7.	<b>A.XHAFERRAJ</b>	18
8.	<b>A.ZARKA</b>	25
9.	<b>E.ALVORA</b>	10
10.	<b>E.MUSTAJ</b>	6
11.	<b>E.VISOÇI</b>	4
12.	<b>F.CELA</b>	40
13.	<b>H.LAMAJ</b>	38
14.	<b>K.LLAHO</b>	35
15.	<b>M.SOTA</b>	4
16.	<b>S.SMAKA</b>	60
17.	<b>XH.SALIAJ</b>	2
	<b>Total</b>	<b>518</b>

Graf 8



Më i ngarkuari përsa i përket çështjeve të dërguara për gjykim rezulton se ka qënë prokurori z. Dritan Marku, i cili mbulon seksionin e të miturve në këtë prokurori. Kjo ngarkesë ka ardhur për faktin se procedimet penale në këtë seksion janë me autorë të identifikuar dhe pjesa më e madhe e tyre dërgohen për gjykim. Ngarkesa për prokurorët e tjerë ka qënë më e lartë në krahasim me një vit më parë, por diferencat e theksuara i referohen prokurorëve që nuk kanë ushtruar funksionin gjatë gjithë vitit kalendarik.

Gjithashtu vlen të përmendet edhe puna e oficerëve të policisë gjyqësore në hetimin dhe përfundimin e procedimeve penale.

Të dhënat për secilin oficer të policisë gjyqësore janë si më poshtë :

Nr.	Of.Pol. Gjyqësore	Seksioni	Nr. i çështjeve te trajtuar	Statusi				
				Pushuar	Pezulluar	Dërg gjyqit	Mbartur 2020	Tjetër
1	Altin Muça	Krimi Ekonomik	157	42	0	11	62	42
2	Ariela Rexha	Të Mitur	105	21	6	53	15	10

3	<b>Eglantina Nushi</b>	Krimi Ekonomik	132	29	8	18	26	51
4	<b>Ibrahim Hoxha</b>	Vepra te Tjera	70	15	4	11	34	6
5	<b>Granit Cakërri</b>	Vepra te Tjera	137	39	11	19	6	62
6	<b>Mirjan Fani</b>	Krimi Ekonomik	111	42	2	7	33	27
7	<b>Roland Kamberi</b>	Vepra te Tjera	132	20	13	69	18	12
8	<b>Ylber Zoga</b>	Vepra te Tjera	110	34	16	7	13	40

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë kanë patur një ngarkesë të konsiderueshme pune gjatë vitit 2019.

## VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË.

### *VII/1 Marrëdhëniet me zyrën e financës.*

Fondi i shpenzimeve i parashikuar për vitin 2019, në total ka qenë në shumën prej 97 476 874 All.

**A. Shpenzimet për personelin** për prokuroret dhe O.P.Gj është realizuar duke u bazuar në nivelin aktual të pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe në strukturën ekzistuese organike të miratuar deri në këtë moment. Ndërsa për administratën dhe për punonjësit me page grupi shtesë për pozicion në bazë të VKM nr.187 dt.08.03.2017 dhe punonjësit me klasa në bazë të VKM nr.202 dt.15.03.2017. Llogaritja e pagesës së gatishmërisë është realizuar në bazë të Udhëzimit nr.02 datë 29.12.2016 Kreu III-të të Prokurorit të Përgjithshëm. Pagesa është kryer duke u bazuar në grafikun e gatishmërisë vetëm për prokuroret dhe për orët jashtë orarit vetëm për ditët e shtuna, të diela e festa me urdhër të titullarit, si dhe për masat e arrestit në flagrancë e vleftësimin e masave të arrestit për prokurore+OPGJ. Shuma totale për paga për vitin 2019 ka qenë 80 476 473 All.

**B. Shpenzimet për kontributet e sigurimeve shoqërore** janë realizuar në mbështetje të VKM nr. 399 dt. 03.05.2017 i ndryshuar, ku paga maksimale është 105 830 lekë dhe përqindja e derdhur nga punëdhënësi është 15% për sigurimet shoqërore dhe sigurimi i detyrueshëm shëndetësor është llogaritur sipas Ligjit 10383, datë 24.02.2011 i ndryshuar, neni 7 pika 1 e tij ku përcakton se: “Baza për llogaritjen e kontributit është paga bruto e personit të siguruar”. Shuma totale për vitin 2019 për këtë zë është 8 093 188 All nga të cilat 6 724 719 all janë për kontributet sigurime shoqërore 15% dhe 1 368 469 janë për sigurimet shëndetësore 7%.

**C. Shpenzimeve operative** janë parashikuar duke pasur parasysh performancën e shpenzimeve gjatë vitit 2018 dhe pritshmërinë për vitin 2019. Gjithashtu është mbajtur në konsideratë likuidimi i shpenzimeve për avokat, ekspert, përkthyes, etj. Shuma totale për shpenzimet operative është 8 907 213 all, nga të cilat 5 738 585 all janë paguar avokat, ekspert, përkthyes, psikolog.

Rezulton se gjatë vitit 2019 janë shlyer të gjitha detyrimet ndaj të tretëve, e për rrjedhojë nuk ka fatura të pa paguara për vitin 2019.

#### *VII/2. Marrëdhëniet me median dhe publikun.*

Për vitin 2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është caktuar një prokuror si koordinator për marrëdhëniet me median dhe publikun. Nga ana e prokurorit janë mbajtur marrëdhënie korrekte dhe të shpejta si përsa i përket informacionit të kërkuar nga media dhe qytetarët, duke respektuar afatet ligjore në ruajtjen e sekretit hetimor.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar viktimave të veprës penale, duke i njohur me të drejtat e tyre procedurale

#### *VII/3. Rregullsia e mbajtjes së regjistrave dhe raporteve.*

Përsa i përket mbajtjes dhe administrimit të regjistrave, rezulton se mbajtja, administrimi dhe plotësimi i tyre është realizuar me korrektesë dhe në zbatim të urdhërit të Drejtuesit të Prokurorisë Nr.18 dhe 19 datë.15.02.2018.

#### *VII/4. Mbi zbatimin e sistemit CAMS.*

Në sistemin CAMS nga punonjësi i zyrës së regjistrimit hidhen te gjitha të dhënat që pasqyrohen në regjister që në momentin e regjistrimit të materialit kallëzues.

Gjatë vitit 2019 janë konstatuar problematika në funksionim e sistemit CAMS, të raportuara nga zyra e teknologjisë së informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme (si pasojë e azhurnimit të sistemit), ku në shumë raste është kërkuar që të mos vazhdohet me pasqyrimin e të dhënave në sistem për një periudhë të caktuar kohore, duke krijuar vështirësi në hedhjen e të dhënave në këtë sistem.

Si pasojë e mosfunksionimit të procesit të shortimin elektronik, në veçanti në ato raste kur është kërkuar dhe pranuar dorëheqja e Prokurorit si dhe është bërë zëvendësimi i tij, sistemi CAMS, nuk e ka mundur këtë veprim, për rrjedhojë shpërndarja e çështjeve është bërë në mënyrë manuale.

Rezulton se nga prokurorët nuk përpilohen aktet në sistemin CAMS, si dhe në shumicën e rasteve nuk pasqyrohen të dhënat në këtë sistem prej tyre. Kjo ka ardhur për shkak të volumit të madh të punës së secilit prokuror, mosfunksionimit të sistemit CAMS në disa raste, si dhe kohës së madhe që nevojitet për të pasqyruar të dhënat në këtë sistem.

### *VIII/5. Kapacitetet infrastrukturore dhe siguria.*

Ne lidhje me kapacitetet infrastrukturore rezulton se, godina në të cilën ushtron aktivitetin Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është e amortizuar, e pamjaftueshme përse i përket zyrave, pasi në shumë zyra ushtrojnë funksionin e tyre 2 (dy) prokuror ose 2 (dy) OPGJ.

Për gjatë vitit 2019, problematika e cila ka vështirësuar mbarëvajtjen e punës, ka qënë mungesa e ambienteve për arkivë. Për ti dhënë zgjidhje kësaj situate, disa ambiente që shërbenin si zyra për prokurorët, jemi detyruar që ti përshtatim si ambiente arkive.

Problematika e mësipërme, e cila është kaluar me shumë vështirësi gjatë vitit 2019, ka krijuar një situatë të tillë sa për vitin 2020 nuk kemi asnjë hapësirë bosh për ta përshtatur për ambiente arkive.

Në këto kushte, rezulton se dosjet e përfunduara mbahen në zyrë nga çdo Prokuror, situatë e cila përveç mos mjaftueshmërisë së zyrës për ushtrimin normal dhe efikas në ushtrimin e detyrës, ka sjellë dhe vështirësi në administrimin e tyre (dosjeve) të cilat kërkohen të administrohen në kuadër të procedimeve të tjera, apo kur kërkohen kopje të akteve nga personat/institucionet e interesuara.

### *VIII/6. Respektimi i disiplinës në punë dhe etikës.*

Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve, synojnë të krijojnë, ruajnë dhe forcojnë rregullat e sjelljes, si dhe të rrisin efikasitetin e të gjithë prokurorëve në ushtrimin e funksioneve Kushtetuese dhe ligjore, për llogari të shoqërisë, në interes të publikut dhe në emër të shtetit, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale dhe shtetit të së drejtës. Rregullat përkrahin zbatimin e standardeve të larta të sjelljes profesionale të prokurorëve të gjithë niveleve, në përshtatje me sjelljen e duhur në zyrë, në gjykatë dhe jashtë zyrës së tyre, si edhe për forcimin e dinjitetit, pavarësisë dhe integritetit profesional e personal të tyre. Ato shërbejnë si udhëzues për të gjithë prokurorët dhe kandidatët për prokuror në vend, për të rritur ndërgjegjësimin, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në ushtrimin e funksioneve të tyre, si edhe plotësojnë kuadrin e akteve normative të nxjerra për prokurorët, me synim rritjen e transparencës dhe besimit të publikut ndaj prokurorëve.

Në drejtim të respektimit të etikës është treguar kujdes maksimal nga ana e prokurorëve të këtij institucioni, duke treguar sjelljen profesionale, korrekte me të gjitha subjektet e proçedimit penal e më tej.

Është respektuar kodi etik si dhe çdo detyrë është ushtruar në përputhje me aktet dhe ligjet në fuqi.

## VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Vlorë, duke pasur në vëmendje të saj analizën vjetore, arritjet dhe nevojën për përmirësim, shtrirjen dhe përhapjen e kriminalitetit, grup veprat penale më shqetësuese aktualisht ka përcaktuar prioritetet për vitin në vazhdim:

- Rritja e efektivitetit të ndjekjes penale ndaj veprave penale me tendencë në rritje të kriminalitetit, veçanërisht e veprave penale në fushën e narkotikëve dhe trafikimit të tyre.
- Rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike.
- Konsolidimin e luftës kundër krimit ekonomik dhe financiar në vijim të punës së kryer nga njëësia e përbashkët hetimore (seksioni i krimit ekonomik e financiar dhe seksioni i posaçëm).
- Rritjen e numrit të hetimeve pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale.
- Bashkëpunimi më i lartë me strukturat e policisë për krimet e rënda si dhe kontrollet e veprimtarisë së policisë gjyqësore.
- Vëmendje e veçantë ndaj grupeve vulnerabël. Prokuroria do të vazhdojë të ndjekë një politikë penale të përshtatshme ndaj të miturve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara që procedohen penalisht, apo edhe ndaj personave që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në aplikimin e dënimeve alternative
- Forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me të gjitha institucionet që kanë shërbime të policisë gjyqësore dhe koordinimi me institucione të tjera ligj zbatuese si domosdoshmëri në punën e organit të prokurorisë;
- Forcimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dhe bashkëpunimit me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit;
- Përdorimin me efektivitet të fondeve buxhetore për përmirësimin e kushteve dhe ambienteve të punës për prokurorët mbetet një objektiv i rëndësishëm edhe për vitin 2019;

Në vazhdim të punës tonë dhe arritjeve Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë synon të përmirësojë në vijim hetimin e ndjekjes penale, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, respektimin e kushtetutës dhe ligjeve në fuqi duke i treguar profesionalizëm dhe sjellje etike.

DREJTUESI I PROKURORISË

